



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_\_

**PROCES - VERBAL**

**Takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të  
Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile**

Më datë 11 janar 2018, ora 15:00, pranë ambjenteve të “Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri” (CRCA Shqipëri) zhvillohet një takim pune.

Të pranishëm janë nëntë anëtarë të KKSHC-së, përfaqësues të Shoqërisë Civile: z. Blendi Dibra, ZëvendësKryetar i KKSHC-së si dhe anëtarët z. Altin Hazizaj, znj. Zana Vokopola, znj. Arta Dyrmishi, znj. Emanuela Zaimi, znj. Iris Luarasi, znj. Afërdita Seiti, znj. Mirela Koçi dhe znj. Artemisi Shehu. Përfaqësuese nga AMSHC është znj. Mimoza Çorbaxhi.

Takimi u hap nga z. Blendi Dibra, ZëvendësKryetar i KKSHC-së, i cili prezantoi qëllimin e këtij takimi, që ishte vendosja e disa prioriteteve bazë për punën sipas grupeve specifike, por dhe sipas nevojave të sektorit.

Më tej disa anëtarë kërkuan që para se te diskutojnë prioritetet duhet që të vihen në dispozicion të KKSHC-së konkluzionet e takimeve nëpër rrethe, të organizuara nga dy ekspertët e BE-së dhe përfaqësuesit e Këshillit. Të vihet në dispozicion Raporti i përgatitur nga dy ekspertët dhe pastaj të vendosin mbi prioritetet.

Znj. Luarasi sjell në vëmendje se legjitimitimi i funksionimit të KKSHC-së duhet të fillojë nga data 26 dhjetor 2017, dita kur u bë mbledhja për miratimin e Rregullores së KKSHC-së dhe të mos ketë një raport për veprimtarinë gjatë vitit 2017, por të përgatitet një info-paper ku të shpjegohet e gjithë periudha para-përgatitore për konstituimin e tij.

Z. Dibra më tej theksoi se të ndarë në grupe sipas objektit të veprimtarisë që përfaqësojnë duhet të punojnë më shume duke vendosur kontakte me institucionet publike për të shpërndarë informacionin dhe për ta bërë me vizibël punën dhe rolin e KKSHC-së në hartimin e politikave dhe programeve për sektorin e shoqërisë civile.

Të gjithë të pranishmit kërkuan që grupet të vendosen dhe në faqen e AMSHC-së për të ditur kush bën çfarë dhe për të qenë sa më transparent para atyre që i kanë zgjedhur.

Gjithashtu u diskutua se sa shpesh duhet të bëhen takimet? A duhet të mblidhen të gjithë anëtarët e Këshillit apo vetëm anëtarët e grupeve të veçanta për problematika specifike dhe të lihet në dëshirën e gjithë secilit nëse do të marrë pjesë përveç anëtarëve të grupit.

Po ashtu u shpreh mendimi që të ketë nga një koordinator për secilin grup pune dhe të takohen javën e fundit të çdo muaji. Anëtari që do të ofrojë ambientin e zyrës, do të caktojë datën dhe orën e takimit. U ra dakord që të marrin pjesë dhe në takimin e datës 17 janar 2018 të njoftuar me e-mail.

Edhe një herë tjetër z. Dibra thekson ndërveprimin me institucionet publike duke kërkuar që AMSHC-ja të sigurojë bashkëpunimin e KKSHC-së me këto institucione.

Gjithashtu gjithë të pranishmit ishin të mendimit që t'i dërgohet një letër Kryetares së KKSHC-së, ku të kërkohet që të gjitha institucionet publike të dërgojnë pranë AMSHC-së emrat e anëtarëve të KKSHC-së për t'i pasqyruar në faqen web të Agjencisë si dhe pjesëmarrja e tyre në takimet e Këshillit pasi mos prezenca e tyre e vështirëson punën për funksionimin e Këshillit.

Znj. Luarasi tha se disa institucione po shpallin thirrje për dhënie fondesh për shoqërinë civile si p.sh. Ministria e Kulturës dhe se nuk janë në dijeni të fondeve që ato kanë, prandaj duhet të llobojnë për ta bërë taksative dhënien e informacionit mbi këto fonde. Madje z. Dibra shton se duhet të kërkojnë që çdo institucion të ketë një përfaqësues nga KKSHC-ja në takimet që ata bëjnë para thirrjeve me qëllim që të shmangët klientelizmi. I këtij mendimi është dhe z. Hazizaj, i cili thotë se duhet të kërkojnë takim me institucionin publik dhe të informohen mbi fondin që ata kanë.

Znj. Zaimi shton se duhet të kërkojnë transparencë nga Ministrinë për të gjitha fondet që ato kanë lidhur me sektorin e shoqërisë civile për vitin 2017 dhe 2018, në mënyrë që ta bëjnë sa më produktiv rolin e KKSHC-së.

Më tej fjalën e mori znj. Koçi e cila ngre shqetësimin e kushteve dhe procedurave mjaft të vështira për t'u futur në fondet e BE-së dhe shprehet se duhet të llobojnë për t'i ndryshuar disa këto kushte dhe sjell shembullin e 5% të shumës që duhet ta ketë gjendje vetë organizata, gjë që është shumë e vështirë për t'u plotësuar. Pra të mos kërkohet fond garancie pasi jo të gjitha OSHC-të kanë mundësi ta realizojnë.

Ndërhyn z. Hazizaj duke thënë se meqenëse BE ka investuar për ne, duhet ne si KKSHC-së të diskutojmë me përfaqësuesit e BE-së për këtë gjë.

Znj. Luarasi ngrre dhe problemin e regjistrimit të OSHC-ve. Ajo thotë që të bëhen rregullime ligjore për regjistrimin e OSHC-ve si dhe tatimet, se nuk ka një databazë unike dhe të përditësuar.

Z. Hazizaj sugjeron që të ngrihet një grup pune, i cili të merret me amendimet e ligjeve. Ai shprehet: “Unë jam shumë i shqetësuar për ligjin e shërbimeve civile, qeveria po mendon të na i heqe fare fondet neve dhe t’ja kalojë pushtetit vendor. Nuk ka një ligj të veçantë për financimin e OJF-ve për dhënien e shërbimeve civile”.

Znj. Luarasi ndërhyr dhe thotë se është përgatitur një draft ligj dhe fton anëtarët ta rishikojnë së bashku dhe e çojnë për miratim. Të gjithë kërkojnë të ketë financim shërbimesh, por dhe bashkëfinancim me donatorët e huaj që janë në vendin tonë.

Z. Dibra thotë: “Duhet të jemi sa më smart, duhet të bëjmë rekomandimet e duhura. Jemi në fillim të vitit dhe duhet të bëjmë një planifikim axhende dhe buxhetit vjetor. Të përcaktojmë problematikat si: regjistrimi i OSHC-ve, ligji për shërbimin civil si dhe tatim taksat”.

Lidhur me çështjet e financimit të OSHC-ve, anëtarët ngritën një grup pune nga OSHC-të për përgatitjen e një Ligji për Financimin e OSHC-ve dhe ndarjen e tij me KKSHC-në kur të jetë gati. Anëtarët e këtij grupi u caktuan: z. Hazizaj, znj. Luarasi dhe z. Dibra.

Krijohen tre grupe pune për rishikimin dhe amendimin e ligjeve. Një për Ligjin e OSHC-ve, një për Ligjin e taksave dhe një për Ligjin e pushtetit vendor. Koordinatorët e grupeve të punës sipas fushave A, B dhe C të përcaktuara me Ligj u vendosën përkatësisht: znj. Iris Luarasi, znj. Zana Vokopola dhe z. Altin Hazizaj.

Pasi grupet e punës të kenë përfunduar, anëtarët e KKSHC-së do të zhvillojnë:

1. Takim me Zyrën e BE-së në lidhje me financimet e tyre për OSHC-të në Shqipëri
2. Takim me Ministrinë e Financave për çështjet e Taksimit.

Në mbyllje të takimit u kërkua që t’u vihet në dispozicion Matrica e Monitorimit të RoadMap-it.

Takimi tjetër u vendos të mbahet më 1 shkurt 2018.